

BIBLIOTEKA  
KOMBËTARE  
E KOSOVËS  
"PJETËR BOGDANI"




THE NATIONAL  
LIBRARY  
OF KOSOVA  
"PJETËR BOGDANI"

---

Sheshi "Hasan Prishtina", Prishtinë | tel. fax: ++383 38 248 940 , ++383 38 212 416  
e-mail: info.bkk@rks-gov.net | ueb: [www.biblioteka-ks.org](http://www.biblioteka-ks.org)

---

## **bkk-e-shërbime** *manuali i përdorimit*



Të nderuar përdorues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës,

Duke filluar nga data 5 tetor 2020, Biblioteka Kombëtare e Kosovës (BKK) ka marrë të gjitha masat e sigurisë për rihapje të pjesshme të sallave të leximit për përdoruesit, në respektim të protokolleve për të luftuar përhapjen e [Covid 19](#) dhe me regjim të kufizuar operativ.

Numri i përdoruesve në Bibliotekën është i kufizuar, 150 përdorues në të njëjtën kohë. Përdoruesit duhet të kryejnë rezervimet online për të gjitha shërbimet e Bibliotekës në Sistemin elektronik [bkk-e-shërbime](#). Pra, i gjithë procesi do të kryhet në formë elektronike dhe është shërbim elektronik i rezervimit në baza ditore.

Më poshtë i gjeni të gjitha udhëzimet e nevojshme për t'a përdorur Sistemin elektronik [bkk-e-shërbime](#).

## Krijimi i llogarisë elektronike



për të gjithë përdoruesit që tashmë janë të regjistruar në Bibliotekë

1. Kliko butonin ‘Krijë llogarinë’
2. plotësoni formularin elektronik/fushat me të dhënat e nevojshme duke e bashkëngjitur si fotografi: a) Librezën e anëtarësisë për përdoruesit e Bibliotekës ose  
b) Letërnjoftimin për përdoruesit e Këndit Amerikan


The screenshot shows a registration form titled 'Krijë llogarinë' (Create account) on the website of the National Library of Kosovo. The form includes the following fields: Emri (Name), Mbiemri (Surname), Numri personal i identifikimit (Personal identification number), Numri i telefonit (Phone number), Datëlindja (Date of birth), E-mail, Fjalëkalimi (Password), Fjalëkalimi përsëri (Repeat password), and a file upload section for 'Librezë e antaresisë' (Membership card) with a 'Choose File' button. At the bottom, there is a checkbox for 'Unë miratoj përdorimin e të dhënave të mia personale' (I agree to the use of my personal data) and a 'Regjistrohu' (Register) button.

3. Kliko butonin ‘Regjistrohu’

4. Në mënyrë automatike do të pranoni një email ku kërkohet të verifikohet e-mail juaj. Shtypni butonin “Verifiko E-mail adresën”



5. Biblioteka do të vërteton të dhënat e juaja dhe ua dërgon një email me të cilin ju njofton se mund të përdorni shërbimet e bibliotekës në përputhje me masat për të luftuar përhapjen e pandemisë Covid 19 *(kujdes: emaili konfirmues mund të gjendet edhe në spam/junk)*




6. Klikoni butonin [bkk-e-shërbime](#) për të vazhduar me Rezervimin e numrin për lexim apo për të Huazuar Librin/materialin bibliotekar


## Rezervimi i numrit për lexim dhe Rezervimi i materialit bibliotekar

*për të gjithë përdoruesit e Bibliotekës*

1. Plotësoni kredencialet email/password
2. Kliko butonin 'Hyr'




3. Rezervo numrin apo Huazo Librin/materialin bibliotekar



#### 4. Klikoni butonin “Rezervo”

Nëse ka vende të lira në Bibliotekë, në emailin tuaj do të pranoni një konfirmim me të cilin njoftoheni se është rezervuar numri i ulësës dhe salla për lexim




#### 5. Nëse e Klikoni butonin ‘Huazo Librin’ dhe e plotësoni me të dhëna

njëkohësisht mund të Rezervoni numrin dhe të Huazoni Librin

(për Huazim të librit, patjetër duhet ndjekur hapi 6 në mënyrë që të identifikoni njësinë)

Huazimin e librit/materialit bibliotekar mund ta bëni në çdo kohe pasi keni rezervuar numrin



#### 6. Huazo Librin/materialin bibliotekar

a. Identifikoni njësinë (libër, revistë etj.) për huazim në Katalogun elektronik

(<http://80.80.164.14:8991/F/>)

b. Kopjoni ‘Book number’ në katalogun elektronik për njësinë që do ta përdorni

c. Nëse nuk e identifikoni njësinë, në fushën Përshkrimi mund ta përshkruani njësinë që po kërkon. Stafi i bibliotekës do të asistojë përmes komunikimit elektronik duke u mundësuar të identifikoni njësinë.

d. Plotësoni fushën ‘Numri i Librit’ me numrin përkatës të identifikuar më parë

e. Klikoni butonin “Huazo”.

ë. Do të pranoni një konfirmim me të cilin njoftoheni se është rezervuar njësia.